

## **RREGULLORE**

### **PËR**

## **MARRJEN E MASAVE ORGANIZATIVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT, GJATË GJENDJES SË EPIDEMISË SË SHKAKTUAR NGA COVID-19**

### **Neni 1**

#### **Objekti i rregullores**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, procedurave dhe praktikave standarde të punës, në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Instituti i Shëndetit Publik dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë, për vijimin e veprimtarisë së Shërbimit Informativ të Shtetit në kushtet e kufizimeve për shkak të epidemisë COVID-19.

### **Neni 2**

#### **Qëllimi i rregullores**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të garantojë:

1. Vijimësinë normale të punës së institucionit, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.
2. Reduktimin e transmetimit të infeksionit midis punonjësve të SHISH.
3. Sigurimin e një ambienti të përshtatshëm pune, sipas udhëzimeve të dhëna nga Instituti i Shëndetit Publik dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë.
4. Ndërgjegjësimin e punonjësve për rrezikun që sjell epidemia dhe përshtatjen e veprimtarisë në kushtet e saj.

### **Neni 3**

#### **Organizimi i punës gjatë periudhës së epidemisë**

Të gjitha njësitë e SHISH duhet të parashikojnë dhe zbatojnë një Plan Masash për të siguruar:

1. Respektimin e rregullave të zakonshme për realizimin e detyrave të tyre funksionale, si dhe rregullave të përcaktuara nga Instituti i Shëndetit Publik dhe dispozitat e kësaj rregulloreje.
2. Distancimin fizik, sipas rregullave të miratuara nga autoritetet shtetërore shëndetësore.
3. Në rastet kur numri i punonjësve kalon normën e lejuar të sipërfaqes për m<sup>2</sup>, dhe është i pamundur distancimi fizik, për respektimin e distancës prej 2 m, atëherë Drejtuesit e njësive të bëjnë ndarjen e punonjësve në grupe, për të ulur frekuentimin në të njëjtën orë, të zyrës ose për të shtuar mjedise pune. Në zyra me sipërfaqe nën 20 m<sup>2</sup> të punojë vetëm një punonjës. Në zyra me sipërfaqe nga 20 m<sup>2</sup> – 30 m<sup>2</sup> të punojnë jo më shumë se 2 punonjës. Drejtuesi i njësisë duhet të hartojë në mënyrë të detajuar grafikun e punonjësve sipas turneve (kur puna mund të kryhet me turne).

4. Ofrimin e shërbimeve ndaj personave të interesuar, gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, përmes distancimit fizik dhe pajisjes me mjete mbrojtëse.
5. Shmangien e mbipopullimit të ambienteve që përdoren për takime dhe pritje, si dhe sigurimit, ventilimit/ajrimit të shpeshtë të tyre.

#### **Neni 4**

#### **Masat e përgjithshme të higjienës**

1. Të gjithë punonjësit e SHISH dhe vizitorët duhet të hyjnë në ambientet e institucionit, duke kaluar nga ura dezinfektuese.
2. Punonjësi i sigurisë bën matjen e temperaturës së trupit. Rastet e dyshuara raportohen pranë strukturës përgjegjëse të caktuar nga Drejtori i SHISH.
3. Të kryhet një herë në 15 ditë dezinfektim tërësor i mjediseve të punës.
4. Për mbajtjen e lidhjeve me autoritetet mjekësore dhe të shëndetit publik, gjatë zgjatjes së epidemisë COVID-19, do të ngarkohet Struktura Përgjegjëse në SHISH.
5. Drejtuesit e njësive të sqarojnë dhe përkrahin punonjësit që të raportojnë me saktësi simptomat e mundshme dhe çdo kontakt të dyshimtë me mbartës potencialë, duke i siguruar që kjo nuk sjell pasoja në trajtimin financiar dhe në karrierë.
6. Për punonjësit dhe vizitorët të sigurohet dezinfektimi i duarve, duke vënë në dispozicion dezinfektues në hyrje të godinës. Pas largimit të vizitorëve, të bëhet pastrim në mjediset e frekuentuara prej atyre.
7. Mjediset brenda SHISH që ofrojnë shërbime sociale (bare dhe mensa), përveç respektimit të udhëzimeve të autoriteteve shtetërore dhe qeveritare, të marrin masa për rritjen e distancës mes tavolinave të shërbimit dhe vendosjen e posterave me porosi specifike në mjediset e brendshme.
8. Në tualetet e godinave të vendosen dezinfektuesit me bazë sapuni ose alkooli që kanë të paktën 60% alkool, letër të pastrimit të duarve ose peshqir me një përdorim për pastrimin e sipërfaqeve, kosha të mbyllur për eliminimin e mbetjeve, si dhe në mjediset e brendshme të godinave, të vendosen si kujtesë postera me porositë e nevojshme higjienike. Postaret do të kenë si bazë informacioni atë të autoriteteve shëndetësore dhe rregullat e brendshme.
9. Njësia përgjegjëse për kryerjen e shërbimeve të marrë masa për pastrimin dhe dezinfektimin më të shpeshtë të ambienteve të përbashkëta, për gjatë të gjithë kohës së zgjatjes së epidemisë COVID-19.

#### **Neni 5**

#### **Puna në terren**

1. Punonjësit e SHISH duhet të respektojnë rregullat e distancimit fizik dhe të përdorin mjetet mbrojtëse gjatë udhëtimit dhe punës në terren.
2. Për punonjësit që punojnë në terren, gjatë kohës kur transporti publik nuk funksion, transporti i tyre të organizohet me makinat e institucionit apo mes kolegëve me makinat e tyre personale.
3. Eprorët direkt që kanë punonjës në terren, duhet të mbajnë evidenca të hollësishme të veprimtarisë dhe kontakteve të tyre, të dhëna të cilat mund t'u shërbejnë autoriteteve

të shëndetit publik, në rast se ndonjëri prej tyre shfaq simptoma ose preket nga sëmundja infektive COVID-19.

4. Automjetet e institucionit të lëvizin për nevoja pune me jo më shumë se dy punonjës (përfshirë shoferin, i cili mban detyrimisht doreza dhe maskë). Në rastet kur në shërbim duhet të shkojnë dy apo më shumë punonjës, përdorimi i automjetit të kryhet nga vetë punonjësit.

## **Neni 6**

### **Zhvillimi i mbledhjeve gjatë periudhës së epidemisë**

1. Mbledhjet dhe takimet e grupeve të punës të organizohen në formën e video konferencave, duke përdorur platformat e komunikimit *online*. Në rast se nuk është i mundur zhvillimi i video konferencës *online*, atëherë takimet të zhvillohen në mjedise me hapësira të mjaftueshme (salla), duke respektuar normat e distancimit dhe higjienës.
2. Në ambientet ku do të zhvillohen takimet, përpara zhvillimit të tyre duhet të:
  - a) garantohen materialet e nevojshme higjieno – sanitare, si sapun, dezinfektantët me bazë alkooli që kanë të paktën 60% alkool, letër të pastrimit të duarve ose peshqir me një përdorim për pastrimin e sipërfaqeve, maska mbrojtëse, kosha të mbyllur për eliminimin e mbetjeve;
  - b) të sigurohen dhe administrohen listat me emrat e pjesëmarrësve dhe kontaktet e tyre, si nr. tel., *e-mail*, adresa ku ata janë duke qëndruar;
  - c) të informohen pjesëmarrësit se të dhënat e tyre do t'i përcillen autoriteteve të shëndetit publik, nëse ndonjëri prej tyre shfaq simptoma ose preket nga sëmundja infektive COVID-19. Nëse ata nuk pajtohen me kushtet e mësipërme, nuk do të lejohen të marrin pjesë në takim;
  - d) të përcaktohen vendet ku do të ulen pjesëmarrësit në mënyrë që të ruhet distanca prej së paku 2 m nga njëri – tjetri;
  - e) nëse gjatë zhvillimit të takimi, ndonjëri nga pjesëmarrësit nuk ndjehet mirë dhe shfaq simptoma të infektimit të mundshëm, të njoftohet menjëherë struktura përkatëse sipas ISSH.
3. Kontaktet e marra shënim për personat pjesëmarrës në mbledhje do të administrohen të paktën për një muaj.
4. Nëse një nga pjesëmarrësit në mbledhje është izoluar më pas si rast i dyshuar për COVID-19, Kryesuesi i mbledhjes do të njoftojë të gjithë anëtarët e tjerë që kanë qenë pjesëmarrës në mbledhje, në mënyrë që të marrin masat e nevojshme.

## **Neni 7**

### **Detyrimet e strukturës përgjegjëse**

1. Me qëllim ndërgjegjësimin dhe parandalimin e përhapjes së epidemisë, Struktura Përgjegjëse duhet të vendosë postera që inkurajojnë zbatimin e rregullave të higjienës, në hyrje të vendit të punës dhe në të vende të dukshme në të gjitha ambientet e punës.

## **Neni 8**

### **Detyrimet e punonjësit**

Me qëllim ndalimin e përhapjes së COVID-19, punonjësi:

1. Nuk duhet të përdorë telefonat, zyrat, mjetet dhe pajisjet e punonjësve të tjerë, kur është e mundur.
2. Në rast se është e nevojshme, ato duhet të pastrohen ose dezinfektohen para dhe pas përdorimit të tyre;
3. Duhet të pastrojë apo dezinfektojë para dhe pas mbylljes së procesit të punës të gjitha pajisjet e tij të punës, si dhe të ajrosë vendin e tij të punës minimalisht 3 (tre) herë në ditë;
4. Duhet të përdorë mjetet mbrojtëse personale, si maska dhe doreza, kur këshillohet;
5. Duhet të aplikojë larjen e duarve, të përdorë dezinfektantë dhe të zbatojë të gjitha masat e higjienës;
6. Duhet të respektojë praktikatat e etikës respiratore të kollitjes dhe teshtitjes, nëpërmjet vënies së gropëzës së bërrylit apo përdorimit të pecetave njëpërdorimshme;
7. Duhet të respektojë distancimin fizik prej 2 m, gjatë kohës së punës;
8. Është i detyruar të deklarojë pranë strukturave përgjegjëse, nëse ka pasur kontakte me persona të infektuar me COVID-19 dhe nëse po duhet të qëndrojë në vetëkarantinim. Struktura përgjegjëse duhet të njoftojë Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor në Qarkun përkatës.

## **Neni 9**

### **Dispozita të fundit**

1. Rregullorja për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë institucionale gjatë periudhës së epidemisë do të afishohet në faqen zyrtare të SHISH, do t'u vihet në dispozicion të gjithë punonjësve në rrugë elektronike, si dhe do të vendoset në një vend të dukshëm brenda ambientit të institucionit.
2. Me njohjen dhe zbatimin e kësaj rregulloreje ngarkohen të gjitha njësitë strukturore të SHISH-it.
3. Me kontrollin e zbatimit të kësaj rregulloreje ngarkohet struktura përgjegjëse e caktuar nga Drejtori i SHISH.